Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

RAPORT I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

RAPORT I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

VITI RAPORTUES 2019



Prishtinë, 2021

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA....3
SHKURTESAT....4
LISTA E TABELAVE, FIGURAVE DHE HARTAVE....5
1.0 HYRJE....6
1.1 Qëllimi i raportit....6
1.2 Metodologjia e mbledhjes së të dhënave....6
2.0 MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUANLE NË KOSOVË....7
2.1 Gjendja aktuale....7
2.2 Gjenerimi i mbeturinave komunale....8
2.3 Deponimi i Mbeturinave Komunale....11
3.0 GJENDJA E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE....12
3.1 Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale....12
3.2 Arkëtimi....16
3.3 Deponitë ilegale....21
3.4 Ndarja e mbeturinave në burim - Riciklimi....24
3.5 Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave....25
3.6 Zbatimi i planeve komunale të menaxhimit të mbeturinave....27
3.7 Operatorët e licencuar për menaxhim të mbeturinave....29
3.8 Asetet komunale për menaxhim të mbeturinave....29
4.0 GJETJET DHE REKOMANDIMET....32
REFERENCAT....33
SHTOJCAT....35

SHKURTESAT

MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
UA	Udhëzimet Administrative
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
MK	Mbeturinat Komunale
MV	Mbeturinat e Vëllimshme
N&D	Ndërtimi dhe Demolimi
LM	Ligji për Mbeturinat
LMM	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave
PAMKOS	Shoqata e Ndërmarrjeve të Kosovës për Mbeturina
PRKMM	Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
RrKMB	Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave
DR	Deponi Rajonale
KRM	Kompani Rajonale e Mbeturinave
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SRKMM	Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë

Lista e tabelave, figurave dhe hartave

Tabela 1.	Sasia e MK të gjeneruara dhe të grumbulluara në Kosovë, (2019)
Tabela 2.	Sasia e MK të deponuara (viti 2019)
Tabela 3.	Mbulimi me shërbim të mbledhjes së MK, (2018 & 2019)
Tabela 4.	Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së MK, (2018 & 2019)
Tabela 5.	Faturimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2019)
Tabela 6.	Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2019)
Tabela 7.	Shkalla (%) e arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2019)
Tabela 8.	Deponitë ilegale sipas madhësisë në rajone, (qershor 2020)
Tabela 9.	Deponitë ilegale sipas fraksioneve në rajone, (qershor 2020)
Tabela 10.	Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave, (2018 & 2019)
Tabela 11.	Operatorët e licencuar për menaxhim të MK
Tabela 12.	Asetet komunale për menaxhim të MK
Figura 1.	Gjenerimi i MK sipas rajoneve dhe në nivel vendi shprehur në kg/banor/vit, (2018 & 2019)
Figura 2.	Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK nga ekonomitë familjare sipas komunave, (2018 & 2019)
Figura 3.	Mbulimi me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare sipas rajoneve dhe në nivel vendi, (2018 & 2019)
Figura 4.	Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare në rajone dhe në nivel vendi, (2018 & 2019)
Figura 5.	Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare sipas komunave, (2018 & 2019)
Figura 6.	Numri i deponive ilegale sipas madhësisë, (qershor 2020)
Figura 7.	Deponitë ilegale sipas fraksioneve të mbeturinave, (qershor 2020)
Figura 8.	Niveli (%) i plotësimit të proceseve të kërkuara në nivel vendi, (2018 & 2019)
Harta 1.	Gjenerimi i MK në komuna shprehur në kg/banor/vit, (2018 & 2019)
Harta 2.	Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK sipas komunave, (2018 & 2019)
Harta 3.	Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2018 & 2019)
Harta 4.	Deponitë ilegales sipas komunave, (qershor 2020)

1.0 HYRJE

1.1 Qëllimi i raportit

Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina është baza ligjore për aktivitete që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave në Kosovë. Ky ligj dhe udhëzimet administrative përkatëse rregullojnë detyrimet e monitorimit dhe raportimit të të gjithë akterëve në këtë sektor.

Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës - AMMK (Neni 60, i Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Neni 14, paragrafi 1.8 i Ligjit Nr. 04/L-060) i janë përcaktuara detyrat si dhe përgjegjësitë për krijimin e bazës së të dhënave dhe sistemit për menaxhimin e mbeturinave. AMMK është gjithashtu përgjegjëse për hartimin raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave.

Ky raport ka për qëllim të ofroj një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të besueshme mbi menaxhimin e mbeturinave komunale në nivel të komunave, përmes të cilit orientohet zhvillimi i politikave strategjike, monitorimi dhe implementimi i strategjisë kombëtare për menaxhimin e integruar të mbeturinave, vlerësimi i performancës së komunave si dhe nxitja e investimeve të mirë planifikuara me fokus në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, shëndetit publik dhe aspekteve ekonomike.

Përmbajtja e këtij raporti paraqet një pasqyrë aktuale mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, përfshirë: zbatimin e legjislacionit, mbulueshmërinë me shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave, faturimin dhe arkëtimin, regjistrimin e deponive ilegale, sasinë e mbeturinave komunale të grumbulluar dhe të gjeneruar sipas komunave, të dhëna lidhur me nismat e komunave për ndarjen e mbeturinave në burim etj.

Në përmbajtjen e këtij raporti janë paraqitur të dhënat për vitin raportues 2019, duke përdorur metodën krahasimore me të dhënat e viteve paraprake 2017/2018.

1.2 Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Para fazës së raportimit, me mbështetjen e Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar - GIZ Kosova, AMMK dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) kanë zhvilluar takime ku është diskutuar për formatin, procedurën, si dhe afatet e raportimit për menaxhimin e mbeturinave komunale për vitin 2019.

Të dhënat në këtë raport janë marrë nga raportimi i komunave dhe kompanive të licencuara që merren me mbledhje dhe transport të mbeturinave komunale, kompanitë e menaxhimit të deponive si dhe nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Ky është viti i dytë radhazi që akterët e lartëcekur raportojnë përmes formatit të raportimit që AMMK ka hartuar me qëllim të raportimit të standardizuar.

Ky raport është hartuar duke përdorur të dhënat e raportuara nga:

- Komunat përmes zyrtarëve komunal, përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave;
- Operatorët e mbledhjes së mbeturinave (KRM, NK, etj.);
- Kompanitë e menaxhimit të deponive (KMDK, KRM etj.).

Rezultatet e të dhënave për deponitë ilegale janë të bazuara nga regjistrimi në terren i realizuar në të gjitha komunat në periudhën qershor 2020, dhe më pas këto të dhëna janë raportuar në formularët e standardizuar të AMMK-së.

Për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të raportuara në mes tjerash për numrin e amvisërive të shërbyera, arkëtimit, deponimit të mbeturinave, qasjes në infrastrukturën për ndarje në burim etj. është kërkuar dokumentacioni i nevojshëm nga komunat dhe opratorët. Këto dokumente janë: pasqyra financiare, lista faturimi, raporte mbi sasitë e deponuara të mbeturinave etj.

Verifikimi i të dhënave të raportuara për deponitë ilegale është bërë përmes vizitave në lokacione të përzgjedhura në terren.

Këto të dhëna dhe dokumente pastaj janë shqyrtuar nga grupi i ngushtë punues brenda MMPHI-së, janë dhënë vlerësimet dhe janë nxjerrë rezultatet e raportit për menaxhimin e mbeturinave komunale për vitin 2019.

AMMK e ka përcjellë draftin e raportit tek komunat për ta shqyrtuar edhe një herë, dhe për t'i evituar gabimet eventuale e të dhënave të përpunuara.

2.0 MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

2.1 Gjendja aktuale

Menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin nr. 64/L-060 për Mbeturinat, si dhe me aktet e tjera nënligjore. Është vërejtur një aktivizim më i madh i akterëve të menaxhimit të mbeturinave, me ndërmarrjen e iniciativave konkrete për përmirësimin e gjendjes në këtë sektor. Mirëpo, pa zbatimin e mirëfilltë të bazës ligjore, investimeve dhe projekteve konkrete në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave, nuk do të ketë përmirësim të gjendjes në këtë sektor.

Bazuar në të dhënat e siguruara dhe të pasqyruara në raport, ku përfshihet i gjithë cikli i mbeturinave, duke filluar nga prodhimi e deri tek trajtimi përfundimtar i tyre, vërehet një lëvizje në përmirësim të treguesve. Problematikë e madhe në nivel vendi ende vazhdon të mbetet deponimi i pjesës dërmuese të mbeturinave të gjeneruara. në deponitë sanitare.

Ende nuk ka iniciativa të mirëfillta qoftë në nivel lokal apo në nivel vendi, që tregojnë veprime konkrete drejt një ekonomie qarkore.

Të dhënat e raportuara për këtë vit raportues nuk janë gjithëpërfshirëse, ka disa mangësi për të gjitha aspektet si: gjenerimin, gumbullimin, trajtimin etj. Megjithatë, të dhënat e raprotuara i janë nënshtruar procesit të verifikimit.

Sasia e mbeturinave të grumbulluara gjatë vitit 2019 është për 2.19 % më e madhe krahasuar me vitin e kaluar, kurse gjenerimi i mbeturinave që bazohet në sasinë e mbeturinave të grumbulluara në vitin 2019 është 269.18 kg/kokë banori/vit, sasi kjo më e vogël për 15.46 kg krahasuar me vitin paraprak.

Mbulimin me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale në vitin 2019 është 78.5%, krahasuar me vitin paraprak ka shënuar një rritje të vogël prej 2.9%.

Edhe këtë vit raportues është regjistruar një gjendje e rëndë e deponive sanitare në Kosovë, e cila vjen duke u rënduar si pasojë e keqmenaxhimit, mos investimeve rehabilituse, por edhe nga tejkalimi i kapaciteteve të pranimit të masës së mbeturinave.

2.2 Gjenerimi i mbeturinave komunale

Si rezultat i bashkëpunimit me komunat gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave sa i përket menaxhimit të mbeturinave komunale është siguruar nivel i kënaqshëm i databazës. Megjithatë, këto dhëna nuk mjafojnë për të siguruar një pasqyrë të kompozicionit të mbeturinave qoftë nëpër komuna individuale apo edhe në nivel të rajoneve, e po ashtu as të dhëna të diferencuara për sasinë e mbeturinave të gjeneruara nga zonat rurale apo urbane.

Sidoqoftë, bazuar në të dhënat e sigurura nga raportet e komunave dhe operatorëve që merren me menaxhimin e mbeturinave komunale, sasia totale e mbeturinave të gjeneruara mund të llogaritet vetëm në bazë të një gjenerimi mesatar për banorë në nivel komune dhe në nivel vendi.

Rrjedhimisht, bazuar në raportin për sasinë e grumbulluar të mbeturinave, dhe duke pasur parasysh numrin e banorëve të shërbyer, mund të llogaritet nomra e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori në ditë, që në nivel vendi rezulton 0.74 kg/banor/ditë.

Duke marrë parasysh numrin prej 1.779.521 banorëve në vend (regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 dhe vlerësimin e popullsisë për Mitrovicën Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan) dhe sasinë vjetore të mbeturinave komunale për kokë banori, që është afërsisht 0.74 kg/banor/ditë, sasia e përgjithsme e mbeturinave të gjeneruara rezulton të jetë rreth 480,648.62 ton/vit.

Sa i përket mbeturinave të vëllimshme, bazuar në të dhënat e raportuara nga komunat, në regjionin e Prizerenit janë mbledhur 5,214.64 t/vit, kurse për regjionet tjera sasi më të vogla ose fare *(shih tab.1).*

Të dhënat e detajuara lidhur me sasinë e mbeturinave të grumbulluara dhe të gjeneruara janë dhënë në shtojcën 1 të raportit.

Tabela 1. *Sasia e MK të gjeneruara dhe të grumbulluara në Kosovë, (2019)*

		Të dhëna të përgjithshme dhe të shërbimit				Sasia e mbeturinave të grumbulluara (2019)		Gjenerimi i mbeturinave komunale (2019)[1]	
	RAJONI	**Numri i banorëve (ASK-2011)**	**Numri i banorëve të shërbyer**	**Numri i ekonomive familjare (ASK-2011)**	**Numri i ekonomive familjare të shërbyera (12/2019)**	**Mbeturinat e përziera komunale të grumbulluara (ton/vit)**	**Nga të cilat të vëllimshme (ton/vit)**	**Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/ vit)**	**Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/ ditë)**
R1	**RAJONI I PRISHTINËS**	470,583	563,984	85,104	107,470	139,806.41	200.56	247.89	0.68
R2	**RAJONI I MITROVICËS**	206,734	184,232	36,312	32,302	54,005.67	202.00	274.38	0.75
R3	**RAJONI I PEJËS**	174,235	148,183	30,266	25,758	56,774.00	0.00	383.13	1.05
R4	**RAJONI I PRIZRENIT**	387,828	368,363	60,651	57,750	83,477.04	5,214.64	226.62	0.62
R5	**RAJONI I FERIZAJT**	185,695	109,134	31,001	18,059	31,158.68	0.00	285.51	0.78
R6	**RAJONI I GJILANIT**	188,188	98,449	34,387	18,011	35,082.21	0.00	344.45	0.94
R7	**RAJONI I GJAKOVËS**	140,659	101,974	22,960	16,648	23,466.76	0.00	230.13	0.63
KOSOVË		1,753,922	1,574,319	300,681	275,998	423,770.77	5,617.20	269.18	0.74



Figura 1. *Gjenerimi i MK sipas rajoneve dhe në nivel vendi shprehur në kg/banor/vit, (2018 & 2019)*

[1] Gjenerimi bazohet në sasinë e mbeturinave komunale të grumbulluara. Në llogaritje nuk janë përfshirë mbeturinat që nuk grumbullohen dhe ato të vëllimshme.



***Harta 1**. Gjenerimi i MK në komuna shprehur në kg/banor/vit, (2018 & 2019)*

2.3 Deponimi i mbeturinave komunale

Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare që menaxhohen nga KMDK-ja për vitin 2019 është **337,397.19 ton/vit** *(shih tabelën 2).* Ndërkaq, në deponitë e tjera sanitare që menaxhohen nga KRM-të, sasia e mbeturinave të deponuara është rreth **112,484.62 ton/vit.**

Kështu, sasia e deponuar e mbeturinave komunale në deponitë sanitare shkon në **449,881.81 ton/vit**, këtu nuk është përfshirë sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë tjera josanitare, si ajo në Istog (Tuqep), apo në deponitë tjera në pjesën veriore të Kosovës, pasi nuk ka të dhëna të raportuara.

Për dallim nga viti paraprak, në vitin 2019 sasia e mbeturinave të deponuara ka shënuar rritje për **24,292.55 ton** më shumë apo shprehur në përqindje **5.7%.**

***Tabela 2**. Sasia e MK të deponuara (viti 2019)*

Deponia /Stacioni i transferit	**Mbeturinat e deponuara (ton/vit)**
Deponia rajonale e Prishtinës (Mirash)	150,921.83
Deponia rajonale e Gjilanit (Velekincë)	66,740.60
Deponia komunale e Podujevës	15,676.18
Deponia rajonale e Prizrenit (Landovicë)	104,058.58
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KMDK-ja:	**337,397.19**
Deponia rajonale e Mitrovicës (Gërmovë)	53,729.62
Deponia rajonale e Pejës (Sferkë)	52,688.00
Deponia komunale e Dragashit	6,067.00
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KRM-të:	**112,484.62**
Gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare:	**449,881.81**
Deponia në Istog (Tuçep) *	
Deponia në Zveçan*	
Zubin-Potokut (Lluçkarekë)*	
Deponia në Leposaviq*	
Gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë josanitare:	
Gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara:	**449,881.81**

**Gjatë këtij viti raportues nuk janë raportuar të dhëna për këto deponi.*

3.0 GJENDJA E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE

3.1 Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale

Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale për ekonomitë familjare deri në fund të vitit 2019 në nivel vendi është 78.5%. Sipas të dhënave të raportuara mbi mbulimin me shërbim, nga 36 komuna sa kanë raportuar në AMMK, 5 komuna tashmë kanë arritur shkallën e mbulimit me shërbim në 100%.

Është me rëndësi të potencohet se për shkak të të dhënave zyrtare tashmë të vjetruara nga ASK (regjistrimi i popullsisë 2011) sa i përket numrit të banorëve dhe ekonomive familjare në komuna, si dhe ndryshimit të madh në trendet e rritjes së popullsisë gjatë këtyre viteve, një numër i konsiderueshëm i komunave kanë numër më të madh të ekonomive familjare të cilat faturohen, në raport me numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare të cilat merren si referencë nga ASK, si p.sh: Komuna e Prishtinës, Fushë Kosovës, Vushtrisë etj.

Gjithashtu, viteteve të fundit, një numër i madh i komunave kanë vendosur të marrin përsipër arkëtimin nga operatorët dhe kanë shfrytëzuar të dhënat e tatimin në pronë për procesin e arktëtimit, apo kanë gjetur ndonjë mënyrë tjetër për të siguruar regjistrimin e ekonomive familjare në regjistrin e arkëtimit.Andaj, numri i ekonomive familjare është shumë më i madh se sa ai në regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare në vitin 2011, duke e pamundësuar kështu paraqitjen reale të të dhënave me gjendjen në terren.

Në anën tjetër, në disa komuna tjera, siq janë: Suhareka, Rahoveci, Kaçaniku, Podujeva etj., operojnë kompanitë private të licencuara për mbledhjen e mbeturinave, por të cilat nuk janë kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik. Andaj, të dhënat (faturimi) që janë raportuar nga këto kompani nuk janë llogaritur.

Në vitin raportues 2019, shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare është 78.5%, duke shënuar kështu një rritje prej 2.9% në nivel vendi krahasuar me vitin 2018.

Kategori tjetër për të cilat komunat kanë raportuar mbulimin me shërbim janë bizneset dhe institucionet. Por, duhet sqaruar se shumë komuna ende nuk kanë arritur të bëjnë një filtrim nga baza e tyre e të dhënave për bizneset e regjistruara me ato që janë aktive, përkatësisht atyre që pranojnë shërbimin e mbledhjes së mbeturinave. Kështu, numri i bizneseve mund t'i paraqesë të gjitha bizneset e regjistruara brenda territorit të komunës, dhe rrjedhimisht mbulimi me shërbim rezulton shumë më i ulët sesa është realisht.

Bazuar në këto të dhëna, mbulimi me shërbim për biznese deri në fund të vitit 2019 ka qenë 51%, ndërsa për institucione 85%.

Për llogaritjen e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave është përdorur përkufizimi i mëposhtëm:

SHm = $\frac{N\ ef.\ sh}{N\ p.\ ef.} x\ 100\%$

* SHm Shkalla e mbulimit
* N ef.sh. – Numri i ekonomive familjare të shërbyera/ të faturuara në dhjetor 2018/2019
* N p.ef. – Numri i përgjithshëm i ekonomive familjare, sipas regjistrimit të popullsisë ASK-2011

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale janë dhënë në shtojcen 2 në raport.

Tabela 3. *Mbulimi me shërbim të mbledhjes së MK, (2018 & 2019)*

		Të dhëna të përgjithshme				Mbulimi me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave			
	RAJONI	**Numri i banorëve (ASK-2011)**	**Numri i ekonomive familjare (ASK-2011)**	**Numri i biznseve aktive në komunë 2019**	**Numri i institucioneve në komunë 2019**	**Numri i ekonomive familjare që pranojnë shërbimin (2018)**	**Numri i ekonomive familjare që pranojnë shërbimin (2019)**	**Numri i biznseve që pranojnë shërbimin (2019)**	**Numri i institucioneve që pranojnë shërbimin (2019)**
R1	**RAJONI I PRISHTINËS**	470,583.00	85,104.00	15,160	498	100,343	107,470	8,141	445
R2	**RAJONI I MITROVICËS**	206,734.00	34,616.00	9,249	355	28,725	32,302	1,439	139
R3	**RAJONI I PEJËS**	174,235.00	30,266.00	5,346	307	23,645	25,758	3,740	307
R4	**RAJONI I PRIZRENIT**	387,828.00	60,651.00	6,726	305	50,499	57,750	6,043	345
R5	**RAJONI I FERIZAJT**	185,695.00	29,516.00	8,570	193	17,213	18,664	2,476	132
R6	**RAJONI I GJILANIT**	188,188.00	32,503.00	5,556	294	19,690	18,011	1,918	278
R7	**RAJONI I GJAKOVËS**	140,659.00	22,960.00	1,455	120	13,821	16,648	2,782	118
KOSOVË		**1,753,922.00**	**295,616.00**	**52,062**	**2,072**	**253,936**	**274,344**	**26,539**	**1,764**

Tabela 4*. Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së MK, (2018 & 2019)*

		Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave				
	RAJONI	**Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2018)**	**Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2019)**	**Rritja ose zbritja e shkallës së mbulimit për ekonomi familjare 2018 -2019 (pikë %)**	**Shkalla e mbulimit me shërbim për biznese (2019)**	**Shkalla e mbulimit me shërbim për institucione (2019)**
R1	**RAJONI I PRISHTINËS**	80.5%	85.2%	4.7%	53.7%	89.4%
R2	**RAJONI I MITROVICËS**	82.7%	83.2%	0.5%	14.4%	35.7%
R3	**RAJONI I PEJËS**	78.1%	85.1%	7.0%	70.0%	100.0%
R4	**RAJONI I PRIZRENIT**	83.3%	95.2%	12.0%	89.8%	100.0%
R5	**RAJONI I FERIZAJT**	58.3%	63.2%	4.9%	28.9%	68.4%
R6	**RAJONI I GJILANIT**	60.6%	55.4%	-5.2%	34.5%	100.0%
R7	**RAJONI I GJAKOVËS**	60.2%	72.5%	12.3%	100.0%	98.3%
KOSOVË		**75.6%**	**78.5%**	**2.9%**	**51.0%**	**85.1%**



***Figura 2**. Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK nga ekonomitë familjare sipas komunave, (2018 & 2019)*



Figura 3. *Mbulimi me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare sipas rajoneve dhe në nivel vendi, (2018 & 2019)*



Harta 2. *Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK sipas komunave, (2018 & 2019)*

3.2 Arkëtimi

Niveli i arkëtimit është një tregues i domosdoshëm i cili trajtohet në këtë raport. Përmes këtij treguesi shohim nivelin e angazhimit të komunave, respektivisht operatorëve në shtrirjen e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale në territorin e tyre.

Në përgjithësi, shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes së mbeturinave deri në fund të vitit 2019 në nivel vendi është 90.4%, përderisa në vitin 2018 ishte 76.64%, duke shënuar kështu një rritje të theksuar në shkallën e arkëtimit prej 13.76 %.

Është me rëndësi të theksohet se operatorët nuk kanë mundur të bëjnë dallimin në mes të arkëtimit nga faturimi për vitin përkatës dhe viteve të kaluara (borxhet e vjetra). Andaj, duhet kuptuar se shkalla aktuale e arkëtimit është më e ulët se ajo që paraqitet nga formula dhe rritja e arkëtimit nuk reflekton domosdoshmërisht rritje në arkëtimin e faturave të vitit përkatës raportues.

Duke pasur parasysh këtë situatë, mund të supozohet se shkalla aktuale e arkëtimit është rreth 10% më e ulët se ajo që rezulton nga formula. Prandaj, mund të thuhet se shkalla reale e arkëtimit në vend është rreth 80%.

Për vitin 2019, nga të dhënat e raportuara, 5 komuna kanë arritur mbi 100%, shkallën e arkëtimit për shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare. Përllogaritja nuk është kufizuar në 100% pasi që në kalkulim të vlerës së arkëtuar hyjnë edhe borxhet e vjetra të klientëve. Shkallën e arkëtimit prej 90% e kanë arritur 9 komuna.

Nëse bëhet vlerësimi i shkallës së arkëtimit në nivel rajoni, atëherë mund të konkludohet se Rajoni i Pejës e ka arritur shkallën më të lartë të arktimit prej 98%, ndërsa shkallën më të ulët të arkëtimit e ka Rajoni i Mitrovicës me 76.62%.

Të dhënat për shkallën e arkëtimit janë llogaritur duke e përdorur formulën në vijim:

$$\text{SHa} = \frac{\text{sh.f.l.v}}{\text{sh.f.a}} x\ 100\%$$

*SHa - Shkalla e arkëtimit

*shf.l.v - Shuma e faturave të lëshuara në vit

*shf.a – Shuma e faturave të arkëtuara në vitin përkatës

Është me rëndësi të sqarohet se në komunat të cilat kanë marrë përsipër arkëtimin dhe kanë zgjeruar bazën e klientëve bazuar në listën e tatimit në pronë, mund të rezultojë që komunat kanë pasur rënie të shkallës së arkëtimit. Kjo për shkak të ndryshimit të modelit të operimit, por edhe sepse numri i faturave është rritur dukshëm, dhe kjo reflektohet në formulë si rënie e shkallës së arkëtimit.

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e arkëtimit janë dhënë në shtojcën 3 në raport.

***Tabela** 5. Faturimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2019)*

		Faturimi për shërbim të mbledhjes së mbeturinave në vitin 2019 (€)			
	RAJONI	**Faturimi për shërbim të ekonomive familjare (2019)**	**Faturimi për shërbim të bizneseve (2019)**	**Faturimi për shërbim të institucioneve (2019)**	**Faturimi për shërbim të për të gjitha kategoritë (2019)**
R1	**RAJONI I PRISHTINËS**	€ 4,664,187.50	€ 776,626.21	€ 1,119,574.02	€ 6,560,387.73
R2	**RAJONI I MITROVICËS**	€ 1,368,982.64	€ 375,851.29	€ 795,837.17	€ 2,540,671.10
R3	**RAJONII PEJËS**	€ 1,336,057.15	€ 431,153.78	€ 214,057.30	€ 1,981,268.23
R4	**RAJONI I PRIZRENIT**	€ 2,300,505.00	€ 271,646.00	€ 74,368.00	€ 2,646,519.00
R5	**RAJONI I FERIZAJT**	€ 948,343.10	€ 350,543.62	€ 206,753.27	€ 1,505,639.99
R6	**RAJONI I GJILANIT**	€ 1,092,628.15	€ 406,176.18	€ 117,610.11	€ 1,616,414.44
R7	**RAJONI I GJAKOVËS**	€ 750,163.00	€ 286,707.04	€ 135,204.38	€ 1,172,074.42
KOSOVË		**€ 12,460,866.54**	**€ 2,898,704.12**	**€ 2,663,404.25**	**€ 18,022,974.90**

***Tabela 6.** Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2019)*

		Arkëtimi për shërbim të mbledhjes *së* mbeturinave në vitin 2019 (€)			
	RAJONI	**Arkëtimi për shërbim të ekonomive familjare (2019)**	**Arkëtimi për shërbim të bizneseve (2019)**	**Arkëtimi për shërbim të institucioneve (2019)**	**Arkëtimi për shërbim për të gjitha kategoritë (2019)**
R1	**RAJONI I PRISHTINËS**	€ 4,854,411.29	€ 667,715.82	€ 500,338.16	€ 6,022,465.27
R2	**RAJONI I MITROVICËS**	€ 882,164.35	€ 332,004.17	€ 732,518.49	€ 1,946,687.01
R3	**RAJONII PEJËS**	€ 1,277,673.11	€ 397,151.61	€ 276,421.69	€ 1,951,246.41
R4	**RAJONI I PRIZRENIT**	€ 2,212,924.00	€ 241,097.00	€ 68,844.00	€ 2,522,865.00
R5	**RAJONI I FERIZAJT**	€ 815,689.71	€ 102,072.29	€ 82,622.98	€ 1,328,877.52
R6	**RAJONI I GJILANIT**	€ 973,026.44	€ 297,489.41	€ 117,303.56	€ 1,387,819.41
R7	**RAJONI I GJAKOVËS**	€ 676,908.00	€253,414.90	€ 137,581.00	€ 1,067,903.90
KOSOVË		**€11,692,796.90**	**€2,290,945.20**	**€1,915,629.88**	**€16,227,864.52**

***Tabela 7**. Shkalla (%) e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2019)*

	Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes së mbeturinave në vitin 2019 (%)				
	RAJONI	**Shkalla e arkëtimit për shërbim të ekonomive familjare (2019)**	**Shkalla e arkëtimit për shërbim të bizneseve (2019)**	**Shkalla e arkëtimit për shërbim të institucioneve (2019)**	**Shkalla e arkëtimit për shërbim të të gjitha kategorive (2019)**
R1	**RAJONI I PRISHTINËS**	104.08%	85.98%	44.69%	91.80%
R2	**RAJONI I MITROVICËS**	64.44%	88.33%	92.04%	76.62%
R3	**RAJONI I PEJËS**	95.63%	92.11%	129.13%	98.48%
R4	**RAJONI I PRIZRENIT**	96.19%	88.75%	92.57%	95.33%
R5	**RAJON I IFERIZAJT**	86.01%	29.12%	39.96%	88.26%
R6	**RAJONI I GJILANIT**	89.05%	73.24%	99.74%	85.86%
R7	**RAJONI I GJAKOVËS**	90.23%	88.39%	101.76%	91.11%
KOSOVË		**93.84%**	**79.03%**	**71.92%**	**90.04%**



***Figura 4.** Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomit familjare në rajone dhe në nivel vendi (2018 & 2019)*



***Figura 5**. Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare sipas komunave, (2018 & 2019)*



Harta 3. *Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2018 & 2019)*

3.3 Deponitë ilegale

Procesi i regjistrimit të deponive ilegale në të gjitha komunat në Kosovë është zhvilluar në qershor të vitit 2020

Deponitë e regjistruara janë kategorizuar sipas madhësisë, përkatësisht si: deponi të mëdha, të mesme dhe të vogla, duke u bazuar në vëllimin e vlerësuar.

Për më tepër, kategorizimi është bërë edhe sipas kompozicionit të mbeturinave, si: (a) deponi të mbeturinave komunale; (b) deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit; (c) deponi të mbeturinave të rrezikshme; (d) deponi të mbeturinave të vëllimshme; dhe (e) deponi të mbeturinave të tjera.

Gjatë këtij procesi, në nivel të Kosovës, në 38 komuna janë regjistruar gjithsej 1490 deponi ilegale të madhësive të ndryshme, ndërsa dominojnë kategoria e deponive të mëdha prej 43%.

Nëse bëhet një krahasim i numrit të deponive ilegale me regjistrimin paraprak në mars 2019 (kur ishin regjistruar 2529 deponi ilegale), mund të vlerësohet se ka një rënie të theksuar të numrit të tyre prej 1040 deponi.

Deponitë ilegale kryesisht dominohen nga mbeturinat e përziera (45%), pasuar nga ato të ndërtim-demolimit dhe ato komunale. Numri më i madhë i deponive ilegale është regjistruar në rajonin e Gjilanit përkatësisht 325 deponi ilegale, kurse më së paku deponi ilegale\ janë regjistruar në rajonin e Gjakovës, përkatësisht 60 prej tyre.

Të dhënat e detajuara për deponitë ilegale janë dhënë në shtojcën 4 në raport.



***Figura 6**. Numri i deponive ilegale sipas madhësisë (qershor 2020)*



***Figura 7**. Deponitë ilegale sipas fraksioneve të mbeturinave, (qershor 2020)*

***Tabela 8.** Deponitë ilegale sipas madhësisë në rajone, (qershor 2020)*

		Deponitë ilegale sipas madhësisë			Deponi ilegale gjithsej
	RAJONI	**Deponi të vogla (1-5 thasë mbeturinash 200 litra)**	**Deponi të mesme (6-20 thasë mbeturinash 200 litra)**	**Deponi të mëdha (>20 thasë mbeturinash 200 litra)**	
R1	RAJONI I PRISHTINËS	72	72	169	313
R2	RAJONI I MITROVICËS	84	84	54	223
R3	RAJONII PEJËS	64	48	29	141
R4	RAJONI I PRIZRENIT	56	60	182	298
R5	RAJONI I FERIZAJT	39	37	51	127
R6	RAJONI I GJILANIT	84	130	111	325
R7	RAJONI I GJAKOVËS	11	9	43	63
KOSOVË		**410**	**440**	**639**	**1490**

***Tabela 9.** Deponitë ilegale siaps fraksioneve në rajone, (qershor 2020)*

		Deponitë ilegale sipas fraksioneve				
	RAJONI	**Mbeturina komunale**	**Mbeturinat të ndërtimit dhe demolimit**	**Mbeturinat indust. dhe të rrezikshme**	**Mbeturinat të vëllimshme**	**Mbeturinat tjera**
R1	RAJONI I PRISHTINËS	27.0%	41.1%	0.0%	0.6%	31.3%
R2	RAJONI I MITROVICËS	46.4%	19.5%	1.2%	1.4%	31.5%
R3	RAJONII PEJËS	46.3%	19.3%	0.3%	0.0%	34.0%
R4	RAJONI I PRIZRENIT	8.2%	33.5%	0.4%	0.0%	57.9%
R5	RAJONI I FERIZAJT	27.3%	37.2%	0.0%	1.1%	34.3%
R6	RAJONI I GJILANIT	28.8%	24.3%	0.0%	0.9%	46.1%
R7	RAJONI I GJAKOVËS	3.3%	18.3%	0.0%	0.0%	45.0%
KOSOVË		**28.0%**	**30.0%**	**0.3%**	**0.8%**	**40.1%**



Harta 4. *Deponitë ilegale sipas komunave, (qershor 2020)*

3.4 Ndarja e mbeturinave në burim - Riciklimi

Në këtë vit raportues nuk është marrë informacion i plotë për aktivitetet e ndarjes në burim dhe riciklim.

Nga komunat është kërkuar të raportohet për numrin e ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave në burim, duke përfshirë këtu të gjitha ekonomitë familjare që janë brenda rrezes 250 m nga një pikë grumbullimi të mbeturinave që ofron ndarje të mbeturinave të riciklueshme, ekonomitë familjare që janë pajisur me komposter dhe ekonomitë familjare në rreze 5 km nga një qendër për grumbullimin e mbeturinave të ndara (nëse ka qendra të tilla në komunë).

Nga 36 komuna sa kanë raportuar për menaxhim të mbeturinave në vitin 2018 dhe 2019, vetëm 7 komuna kanë rezultuar të kenë ofruar qasje në infrastrukturën për ndarje në burim. Këta hapa të parë në drejtim të ekonomisë qarkore i kanë ndërmarrë komunat: Prizren, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Gllogoc, Mitrovicë, Vushtrri dhe Rahovec.

Për të gjitha këto komuna, të dhënat e raportuara janë vërtetuar me dokumente planifikimi dhe me foto dëshmi të lokacioneve, ortofoto, listë të vendbanimeve etj.

Në disa komuna rezulton që pjesa më e madhe e ekonomive familjare kanë qasje në infrastrukturë për ndarje në burim, por në fakt kjo vlerë është më e ulët, Siç është shpjeguar më sipër, kjo ndodh për arsye se numri ekzistues i banorëve, respektivisht i ekonomive familjare sikur p.sh në Fushë-Kosovë, është më i lartë se sa pasqyrohet në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, numër ky që është marrë për bazë në kalkulimin e përqindjes së ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave në burim.

Në përgjithësi, në bazë të të dhënave të raportuara, rezulton se në nivel vendi në vitin 2019 numri i ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndarje në burim është rritur me 3.4%, nga 6.8% sa ishte në vitin 2018.Andaj, sipas të dhënave të vitit 2019, 10.2 % e ekonomike familjare në nivel vendi kanë qasje në infrastrukturën për ndarje në burim. Mirëpo, kjo përqindje duhet të merret me mëdyshje për shkak të arsyeve të lartcekura.

Të dhënat e detajuara lidhur me ndarjen e mbeturinave në burim janë dhënë në shtojcën 5 në raport.

3.5 Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave

Në kuadër të kornizës ligjore që mbulon fushën e menaxhimit të mbeturinave, duhet theksuar Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, nga i cili derivojnë aktet e tjera nënligjore dhe dokumentet planifikuese të nivelit qendror dhe lokal, përcaktohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e komunave për menaxhim të mbeturinave brenda territorit të tyre. Po ashtu, ofron një kornizë zhvillimi për nivelin lokal dhe atë rajonal, për marrjen e masave në realizimin e caqeve dhe objektivave të përcaktuara.

Disa nga obligimet që dalin nga baza ligjore, përmbushja e të cilave është kyqe për t'ua mundësuar komunave zbatimin e ligjit dhe planeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave, janë:

1. Hartimi dhe miratimi i Rregullores për Menaxhim të Mbeturinave;
2. Hartimi dhe miratimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM);
3. Punësimi i përhershëm i zyrtarit për menaxhim të mbeturinave, përshkrimi i punës i të cilit siguron që të paktën 50% e përgjegjësive janë nën menaxhim të mbeturinave;
4. Punësimi i inspektorit mjedisor, përshkrimi i punës i të cilit siguron përgjegjësi në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
5. Kontraktimi i operatorëve të licencuar për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale, duke zbatuar procedurat e prokurimit;
6. Kontraktimi i operatorëve të licencuar për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, duke zbatuar procedurat e prokurimit;
7. Caktimi i tarifave të shërbimit duke kaluar procesin tarifor për mbledhjen, transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale, përmes kalkulimit të kostove të shërbimit, profilizimin e klientëve dhe caktimin e tarifave të shërbimit;
8. Caktimi i qendrës për grumbullim, trajtim dhe deponim të mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore;
9. Strukturen organizative të organizimit të inspektoratit në Komunë, si dhe;
10. Shqiptimin e gjobave mandatorë.

Siq dihet, komunat kanë përgjegjësi të përmbushjes së obligimit ligjor për raportim brenda afatit të përcaktuar deri më 31 mars të vitit vijues për vitin raportues paraprak. Megjithatë, për vitin raportues 2019, për shkak të situatës emergjente si pasojë e pandemisë globale COVID-19, raportimi është shtyrë për një muaj, deri me 30 prill[2], duke e plotësuar pyetësorin që ka nënvizuar edhe kërkesat për dokumentacionin relevant që komuna ka arritur t'i përmbushë.

Bazuar në këto raporte, dhe më pas në verifikimin e këtyre të dhënave, është paraqitur një pasqyrë e përgjithshme e realizimit të proceseve në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave. Në vitin 2019 janë shtuar edhe dy kërkesa për raportim që në vitin 2018 nuk janë kërkuar nga komunat, përkatësisht: struktura organizative e organizimit të inspektoratit në Komunë, si dhe kërkesa për pasqyrën e shqiptimit të gjobave mandatore brenda vitit 2019. Duhet potencuar se në krahasimin e rezultateve të realizimit të proceseve në mes vitit 2018 dhe 2019, këto dy procese nuk janë përfshirë. Kështu, në nivel vendi, në vitin 2019, mesatarja e realizimit të proceseve është 61.5%, duke shënuar kështu një rritje prej 4% krahasuar me vitin paraprak, *(shih tabelen 10).*

[2] Afati i rregullt ligjor për raportim që është 31 mars, është shtyer deri më 31 maj 2020 si pasojë e gjendjes me pandeminë Covid-2019

Tabela 10. *Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave, (2018 & 2019)*

RAJONI	Viti	1.Hartimi dhe miratimi i PKMM	2.Hartimi dhe miratimi i rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave	3.Zyrtari për MM	4.Inspektori mjedisor	5.Kontraktimi i operatorëve të licencuar për mbledhjen e mbeturinave komunale	6.Kontraktimi i operatorëve të licencuar për mbledhjen s mbeturinave të N dhe D	7.Caktimi i tarifave të shërbimit duke kaluar procesin tarifor	8.Caktimi i qendrës për grumbullim, trajtim dhe deponim të mbeturinave të N dhe D	Numri i proceseve të zbatuara
PRISHTINËS	2018	100%	86%	100%	71%	100%	0%	100%	57%	77%
	2019	100%	100%	100%	71%	57%	0%	100%	71%	75%
MITROVICËS	2018	100%	75%	75%	75%	75%	0%	75%	75%	69%
	2019	80%	60%	80%	80%	60%	0%	100%	60%	65%
PEJËS	2018	100%	100%	100%	100%	100%	0%	67%	0%	71%
	2019	100%	100%	100%	100%	33%	0%	100%	33%	71%
PRIZRENIT	2018	50%	50%	67%	100%	67%	0%	0%	67%	50%
	2019	50%	50%	67%	100%	83%	0%	17%	67%	54%
FERIZAJT	2018	100%	25%	50%	75%	75%	0%	0%	75%	50%
	2019	80%	60%	60%	80%	60%	0%	80%	80%	63%
GJILANIT	2018	50%	17%	17%	50%	17%	0%	0%	67%	27%
	2019	71%	43%	43%	57%	57%	0%	0%	43%	39%
GJAKOVËS	2018	67%	100%	100%	100%	67%	0%	33%	100%	71%
	2019	100%	100%	100%	100%	67%	0%	67%	100%	79%
Nr. i Komunave që kanë zbatuar procesin	2018	26	20	23	26	23	0	13	21	19
	2019	29	25	27	29	22	0	22	23	22
Mesatarja e realizimit t ë procesit/eve	2018	78.79%	60.61%	69.70%	78.79%	69.70%	0.00%	39.39%	63.64%	57.6%
	2019	80.56%	69.44%	75.00%	80.56%	61.11%	0.00%	61.11%	63.89%	61.5%



Figura 8. *Niveli (%) i plotësimit të proceseve të kërkuara në nivel vendi, (2018&2019)*

Nëse shikohet nga aspekti rajonal, realizueshmëri më e lartë e proceseve është arritur në rajonin e Gjakovës me 79 %, e përcjellur nga rajoni i Prishtinës me 75% të proceseve të zbatuara, ndërkaq rajoni i Gjilanit ka nivelin më të ulët të realizimit të proceseve në shkallë prej 39%.

Sikurse vitin e kaluar, edhe këtë vit raportues, procesi i cili nuk është realizuar nga komunat është procesi nr. 6. Kjo në pamundësi të kontraktimit të kompanive të licencuara për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi. Kjo dukuri është e ndërlidhur siç duket me mungesën e interesimit për licencimin nga vet ana e kompanive për të ushtruar aktivitetin e grumbullimit të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit. Në anën tjetër, disa komuna kanë ndërmarrë hapa në menaxhim të këtyre mbeturinave duke kontraktuar kompanitë publike që operojnë në territorin e komunave, kompani private ndërtimore apo tjetër.

Proceset që kanë rezultuar më të zbatuarat nga komunat (29 nga 36 komuna) janë: procesi 1, hartimi dhe miratimi i PKMM; dhe procesi 4, inspektori mjedisor.

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e realizimit të proceseve janë dhënë në shtojcën 6 të raportit.

3.6 Zbatimi i planeve komunale të menaxhimit të mbeturinave

Nga 36 komuna të cilat kanë raportuar në AMMK, gjithsej 29 prej tyre kanë raportuar të kenë përmbushur kërkesën ligjore të hartimit të planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, i cili është valid për vitin raportues dhe i miratuar në kuvend komunal. Nga këto komuna, shumica kanë raportuar për zbatim të PKMM, duke përmbushur kërkesën ligjore nga Ligji për Mbeturina (neni 58.2).

Krahasuar me vitin e kaluar, këtë vit raportues më shumë komuna kanë raportuar drejt duke iu referuar Planit të veprimit në kuadër të PKMM, aktiviteteve përkatëse, objektivin përkatës të ndërlidhur me aktivitetin, nivelin e realizimit, dhe po ashtu duke shpjeguar arsyet e mospërmbushjes së aktivitetit. Mirëpo, përsëri ka raste kur aktivitetet e përshkruara në raport nuk e pasqyrojnë drejt PKMM.

Kërkesa që komunat të raportojnë qartë për nivelin e zbatimit të PKMM-së sipas kërkesës në formularin standard, ashtu që të mund të gjenerojmë përqindje të nivelit të realizimit të këtij plani, ka qenë sfidë edhe këtë vit për shumicën prej komunave. Por, edhe në rastet kur komunat kanë bërë përshkrimin e aktiviteteve të realizuara nuk kanë arritur të bëjnë ndërlidhjen me objektivin, nivelin e realizimit dhe as referimin e drejtë me PKMM.

Edhe në këtë vit raportues, komunave u rekomandohet që në vitet e ardhshme të hartojnë PKMM të realizueshëm, ku planifikimi i aktiviteteve dhe resurseve (si njerëzore po ashtu edhe financiare) për realizim të aktiviteteve korrespondojë me mundësitë reale që ka komuna. Po ashtu zyrtarët komunalë për menaxhim të mbeturinave duhet monitoruar dhe raportuar rregullisht lidhur me zbatimin e PKMM-së.

3.7 Operatorët e licencuar për menaxhim të mbeturinave

Në raportet e dorëzuara në AMMK, një numër i konsiderueshëm i komunave ka raportuar edhe për operatorët që operojnë në territoret e tyre. Shumica e komunave kanë të lidhur marrëveshje për operim të mbledhjes së mbeturinave komunale me operatorët e licencuar publik, por disa komuna kanë marrëveshje për mbledhjen e mbeturinave edhe me operator privat. Për vitin raportues 2019, të dhënat e regjistruara nga komunat janë për operatorët e licencuar për mbledhje dhe transport të mbeturinave.

Kompanitë rajonale të mbeturinave (KRM) operojnë në 7 rajone, duke mbuluar kështu mbi 26 komuna me shërbimin e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale.

Në disa komuna si: Deçan, Zveçan dhe Hani i Elezit, operojnë kompani komunale, ndërsa komunat Ranillug dhe Partesh shërbehen nga stafi komunal. Në shumë komuna operojnë edhe kompani private, megjithatë vetëm në komunat Prizren, Mamushë dhe Junik këto kompani janë të kontraktuara sipas procedurave të prokurimit publik.

Këto të dhëna do të jenë pjesë e regjistrit të operatorëve në nivel vendi. Ky regjistër do të rifreskohet çdo vit me të dhëna të reja nga komunat përkatëse.

Një pasqyrë më të qartë të shtrirjes së operatorëve të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komuale e jep tabela në vijim:

Tabela 11. *Operatorët e licencuar për menaxhim të MK*

	Komunat	**Operatorët e licencuar për mbledhje dhe transport të mbeturinave komunale dhe që ofrojnë shërbim në komunë**	
		Operatorët publik	**Operatorët privat**
1	Prishtinë	KRM "Pastrimi"	
2	Gllogoc		
3	Fushë-Kosovë		
4	Graçanicë		
5	Lipjan		
6	Obiliq		
7	Podujevë		Natyra SHPK
8	Mitrovicë	KRM "Uniteti"	
9	Skenderaj		
10	Vushtrri		
11	Mitrovicë e Veriut*		
12	Zveçan	Ndërmarrja publike komunale banesore	
13	Zubin-Potok*		
14	Leposaviq*		
15	Pejë	KRM "Ambienti"	
16	Istog		
17	Klinë		
18	Prizren	KRM "Ekoregjioni"	Is Company Shpk dhe NSH Shërbimi
19	Suharekë		Is Company shpk
20	Malishevë		
21	Rahovec		Eko-Drinia'sh.p.k
22	Dragash		
23	Mamushë		I&S Company SHPK
24	Ferizaj	KRM "Pastërtia"	

25	Kaçanik		NTSH "Krasniqi
26	Shtime		
27	Han i Elezit	NPL "Pastrimi" SH.A	
28	Shtërpcë*		
29	Gjilan	KRM "Ekohigjiena"	
30	Kamenicë		
31	Viti		
32	Novobërdë		
33	Partesh	Komuna Partesh	
34	Kllokot*		
35	Ranillug	Komuna Ranillug[3]	
36	Gjakovë	KRM "Çabrati"	
37	Deçan	Hixhiena Sh.A - Bjeshkët e Deçanit	
38	Junik		VB. TOFAJ SH.P.K.

* Komuna nuk ka raportuar në AMMK për vitin raportues 2019

3.8 Asetet komunale për menaxhim të mbeturinave

Pothuajse të gjitha komunat që kanë raportuar kanë shënuar po ashtu informata për asetet komunale për menaxhim të mbeturinave, ndonëse jo të gjitha të dhënat e kërkuara janë regjistruar apo iu kanë përgjigjur kërkesës në formular. Këto të dhëna janë kërkuar nga niveli lokal për të pasur një pasqyrë të përgjithshme për numrin, shpërndarjen dhe vjetërsinë e aseteve komunale për menaxhim të mbeturinave. Asete komunale janë të gjitha pajisjet të cilat janë në pronë të komunës apo janë pronë e kompanisë publike (në të cilën komuna ka pronësi).

Në bazë të të dhënave të raportuara, 36 komuna në Kosovë kanë në shërbim 258 kamionë për grumbullim dhe transport të mbeturinave dhe 34 traktora transportues. Mosha mesatare e kamionëve është rreth 14 vjet.

Komuna e Prishtinës ka numrin më të madh të makinerisë për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave me gjithsej 40 kamionë (me kompaninë publike "Pastrimi"), e pasuar nga Komuna e Prizrenit me gjithsej 24 kamionë (me kompaninë publike "Ekoregjioni"). Disa komuna si: Mamusha, Novobërda, Kllokoti, Ranillug, Junik kanë vetëm nga një mjet transportues/kamion të mbeturinave komunale.

Gjithashtu, është raportuar edhe për pajisje të tjera, asete komunale, për kontejnerë, për numrin e tyre dhe kapacitetin. Kështu, 36 komuna kanë raportuar se kanë 67,160 kontejnerë duke filluar nga ata 120 litra, e deri tek ata me kapacitet 15m^3 që shërbejnë për transfer të mbeturinave në deponi. Numrin më të madh të kontejnerëve e ka raportuar komuna Gllogocit me 7,939 kontejnerë e pasuar nga komuna e Fushë Kosovës me 7,832 kontejnerë. Ndërsa, numër më pak se 100 kontejnerë kanë raportuar komunat: Dragash, Viti, Partesh, Istog, Shtërpcë.

Pasqyrë më e qartë rreth aseteve komunale për menaxhimin e mbeturinave është dhënë në tabelën në vijim.

[3] *Komuna Ranillug ka një department që merret me mbledhjen e mbeturinave.*

Tabela 12. *Asetet komunale për menaxhim të MK*

Asetet e komunave për grumbullim dhe transport të mbeturinave				
#	**Komunat**	**Numri i kamionëve**	**Numri i traktorëve**	**Numri i kontejnerëve**
1	Prishtinë	40	2	1886
2	Gllogoc	7	0	7939
3	Fushë-Kosovë	7	0	7832
4	Graçanicë	3	0	3262
5	Lipjan	12	3	1783
6	Obiliq	0	0	560
7	Podujevë	14	0	2051
8	Mitrovicë	15	3	262
9	Skenderaj	9	2	3031
10	Vushtrri	13	1	1013
11	Mitrovicë e Veriut*			
12	Zveçan	2	1	1301
13	Zubin-Potok	4	0	374
14	Leposaviq*			
15	Pejë	16	0	2139
16	Istog	0	0	0
17	Klinë	4	0	2860
18	Prizren	24	3	1033
19	Suharekë	6	2	210
20	Malishevë	8	2	123
21	Rahovec	6	0	2635
22	Dragash	7	2	55
23	Mamushë	1	2	745
24	Ferizaj	13	1	1848
25	Kaçanik	5	1	3428
26	Shtime	3	3	2163
27	Han i Elezit	2	1	1053
28	Shtërpcë	0	0	0
29	Gjilan	9	1	4161
30	Kamenicë	3	0	5892
31	Viti	0	0	3
32	Novobërdë	1	0	474
33	Partesh	0	0	1
34	Kllokot	1	0	150
35	Ranillug	1	0	504
36	Gjakovë	13	3	1605
37	Deçan	8	1	3582
38	Junik	1	0	1202
TOTAL		**258**	**34**	**67160**

** Komuna nuk e ka dorëzuar raportin në AMMK për vitin raportues 2019*

4.0 Gjetjet dhe rekomandimet

Përmbledhja e mëposhtme paraqet gjetjet dhe rekomandimet e gjendjes aktuale të menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë për vitin raportues 2019:

- Rreth 90% e sasisë së mbeturinave të gjeneruara përfundon në deponitë sanitare, kurse pjesa tjetër e gjeneruar përfundon në deponi josanitare. Politikat zhvillimore duhet të përqendrohen në parandalimin e gjenerimit dhe deponimit të mbeturinave përmes trajtimit;

- Mbulimi me shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave është duke u rritur nga viti në vit, nga 57.7% në vitin 2016, 70.9% në vitin 2017, 75.6% në vitin 2018 në 78.5% në vitin 2019;

- Shkalla e arkëtimit në Kosovë edhe gjatë këtij viti raportues ka qenë e vështirë për t'u vlerësuar, për shkak të përfshirjes së borxheve të vjetra në vlerën e arkëtuar.Por, supozohet se arkëtimi real për shërbimin e kryer brenda vitit 2019 është rreth 80%. Komunat, përkatësisht operatorët duhet të bëjnë qartazi dallimin e borxheve të arkëtuara nga arkëtimi i vitit raportues;

- Qëndrueshmëria financiare në sektor ende është sfiduese;

